

AKTI I THEMELIMIT
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“MadWay Global” sh.p.k

Themeluesit qe nenshkruajne me poshte jane si vijon:

Z. Alper Sagoglu, i datelindjes 27.11.1985, atesia Recep, amesia Cavidan, lindur ne Sisli/Turqi dhe banues ne Konaklar Mahallesi, Sebboy Sokak, Armakent Sitesi, D1 Blok, Daire 5, Besiktas, Stamboll, Turqi, identifikuar me pasaport nr. U23533858 dhe nr personal turk 33193398470 madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

Qe ne vijim do te quhen Ortaku i Shoqerise “MadWay Global” sh.p.k

Sot me date **25.10.2024**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, vendosi te themelloje Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i shoqerise

Shoqeria Tregtare “**MadWay Global**” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Konsulence per zhvillim biznesi, manaxhim investimesh. Agjenci turizmi shendetsor. Shitblerje e pajisjeve mjekesore dhe paramedikale. Trajnim per perdorim teknologjik te aparaturave mjekesore dhe servisi i tyre. Dhenja me qira e mjeteve dhe aparaturave te ndryshme.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertojne “**MadWay Global**” sh.p.k Selia juridike e Shoqerise ndodhet ne Njësia Administrative 5, Rruga Abdyl Frashëri, Pallati Hekla, Shk.1, K.9, Ap.45, Kodi Postar 1019, Tiranë Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjenci ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni 3

Forma Juridike

1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi
2. Me vendim te ortakeve mund te ndryshoje formen juridike te Shoqerise, ne qofte se ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Ne kete rast ortaket do ta pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te bejne regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar, ne organet kompetente shqiptare.
3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne regjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.
4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne nje shoqeri tjeter ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaku merr pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vet ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
6. Ortaku ka te drejte te marri te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Alper Sagoglu**, zotërues 1 (nje) kuote me vlere 100.000 lek, qe perfaqeson **100% (njqind perqind)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

Kreu IV

PERSONALITETI JURIDIK

Neni 7

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne ditën e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Biznesit, si dhe fillon veprimtarine e saj me marrjen e licences te ushtrimit se veprimtarise.

Kreu V

ADMINISTRIMI

Neni 8

Shoqeria do te administrohet nga administratori **Alper Sagoglu** i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.

Kreu VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i mbetet Ortakut te saj, ta ndaje si dividend apo ta shtoje ne kapitalin e shoqerise. Ky Akt shtypet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

Alper Sagoglu

2

Alper Sagoglu

